

**Vendim i Asamblesë së Përgjithshme
së Ortakëve të shoqërisë Business & Tax Advice shpk**

Sot më datë 01/09/2021, në selinë e shoqërisë “Business & Tax Advice” sh.p.k, në adresën Rr. Sami Frashëri, Ndërtesa 19, Hyrja 8, Kt.5, Ap.14, Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

Në mbledhje merrnin pjesë ortakët si më poshtë:

- Elona Bisha, e cila zotëron 90% të pjesëve të kapitalit
- Artur Papajani, i cili zotëron 5% të pjesëve të kapitalit
- Asllan Shera, i cili zotëron 5% të pjesëve të kapitalit

Mbledhja e asamblesë së ortakëve të shoqërisë drejtohet nga Administratori Z.Artur Papajani.

Z. Papajani, pasi konstatoi se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë ortakët e shoqërisë dhe është realizuar quorumi i nevojshëm për marrjen e vendimeve të vlefshme, e deklaroi atë të hapur dhe paraqiti rendin e ditës:

1. Shitjen nga ortaku Elona Bisha te 90% te kapitalit te zoteruar ne shoqeri, blesit Blerta Bendo;
2. Të tjera.

Ortakët e pranishëm në mbledhje pasi shqyrtuan rendin e ditës, në mënyrë unanime dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të plote:

VENDOSËN

1. Shitjen e 90% te kapitalit te zoteruar ne shoqeri nga ortaku Elona Bisha, blesit Blerta Bendo;
2. Pas realizimit te ketij transferimi me nenshkrimin e kontrates se shitjes se kuotave, ortake te shoqerise “Business & Tax Advice“ shpk do te jene:
 - Artur Papajani, i cili zoteron 1 kuote qe perfaqeson 5% te kapitalit te shoqerise, me vlere 50,000 leke;
 - Asllan Shera, i cili zoteron 1 kuote qe perfaqeson 5% te kapitalit te shoqerise, me vlere 50,000 leke;
 - Blerta Bendo, e cila zoteron 1 kuote qe perfaqeson 90% te kapitalit te shoqerise, me vlere 900,000 leke;
3. Depozitimim e ketij vendimi prane QKB-se, sipas afatit ligjor.

Pasi nuk pati çështje të tjera për diskutim, Kryetari i mbledhjes e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Artur Papajani



Ortakët e shoqërisë

Asllan Shera



Elona Bisha

